



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KZAZ NR. 35, KZAZ NR. 40 DHE KZAZ NR.33 PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ nr. 35, KZAZ nr. 40 dhe KZAZ nr. 33 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- lirim të anëtares të KZAZ nr. 35, zj. Blerina Mancellari dhe emërim të z. Erald Breganaku, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 4970 prot., datë 29.05.2019,
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 40, z. Rezart Sulstarova dhe emërim të zj. Olsida Goxhaj, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 4971 prot., datë 29.05.2019,



Nr. 726 i Vendimit Data 30.05.2019 e Vendimit Ora 17:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ nr. 35, KZAZ nr. 40 dhe KZAZ nr. 33 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 33, z. Donald Fetah dhe emërim të z. Nesti Ndoci, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 5003 prot., datë 30.05.2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 35, zj. Blerina Mancellari; anëtarin e KZAZ nr. 40, z. Rezart Sulstarova; anëtarin e KZAZ nr. 33, z. Donald Fetah, Bashkia Tiranë.
2. Të emërojë anëtarin e KZAZ nr. 35, z. Erald Breganaku; anëtarin e KZAZ nr. 40, zj. Olsida Goxhaj; anëtarin e KZAZ nr. 33, z. Nesti Ndoci, Bashkia Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |

